



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 70 prot.

Kamëz më 18.04.2023

V E N D I M

Nr. 56 Datë 18.04.2023

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPRONËSIM NË INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË RRUGËS "JUSUF GERVALLA" ZALL-MNER

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.04.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.35, Datë 18.04.2023, bazuar në shkronjën "dh" dhe "k" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik" të ndryshuar; VKM-në nr. 127, datë 23.03.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik"; VKM-në nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik"; VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit të rrugës "Jusuf Gervalla";
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kamëz;
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme [REDACTED] do të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, për pasurinë nr. 8/565, zonë kadastrale 2066, lloj i pasurisë Truall, me sipërfaqe totale 298.3 m², ndërtesë 136.5 m²



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Dokumentacionet përkatëse si dhe vlera e shpronësimit do t'i përcillen Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

